

KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 620 Prot.

Tiranë, më 10.052017

VENDIM Nr. 59, datë 26.04.2017

Në mbështetje të Ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Neni 41 dhe 43, VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.7, datë 26.04.2017, pasi shqyrtoi *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Dr. Etleva Nallbani dhe Dr. Elvana Metalla, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë,

VENDOSI:

1. Të miratojë *Projektin kërkimor shkencor në vazhdim "Koman"*, miratuar nga Këshilli Shkencor i Institutit të Arkeologjisë (Qendra e Studimeve Albanologjike), drejtues Dr. Etleva Nallbani dhe Dr. Elvana Metalla, paraqitur nga Instituti i Arkeologjisë, në lidhje me veprimtarinë e mëposhtme:

Gërmime në Koman

- Gërmime në zonën e poshtme të kodrës së "Kalasë", lagjia e "Qafës" (Zona 1B).
- Gërmime dhe konsolidime në lagjen e kishës së Shën Gjergjit.
- Pastrime në zonën e Nekropolit qendror. Do të vazhdojë konsolidimi i varreve të zbuluara nga gërmimet e vjetra dhe rilevimi i tyre.
- Pastrimi dhe lehtësimi nga gurët e rrënuar të kishës së Shën Todrit, e identifikuar në lagjen e poshtëme perëndimore të kodrës së "Kalasë".

Aktiviteti në terren në Sardë

- Pastrime të mëdha të dy mureve rrethues të qytetit.
 - Pastrime të kompleksit të identifikuar si banesë civile, por që rezultoi kishë (shoqëruar me sondazhe të vogla sqaruese).
2. Periudha kohore e kryerjes së punimeve do të jetë do të jetë periudha kohore e nevojëshme për kryerjen e tyre, brenda vitit 2017.
 3. Në rastet kur parashikohet ndërhyrje në sit/nëntokë dhe evidentohen struktura, duhet të përcaktohen masat që do të merren për konservimin/restaurimin/translokimin e tyre. Gjithashtu, në çdo rast, duhen përcaktuar masat për rehabilitimin e zonës.
 4. Të depozitohet pranë ASHA dhe DRKK lista e gjetjeve me qëllim grumbullimin dhe ekspozimin e tyre në Muze.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

KRYETAR
MIRELA KUMBARO EURXHI
MINISTËR



SEKRETAR I KKA
RUDINA ZOTO